

**VENDIM**  
**Nr. 785, datë 7.10.2020**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK,  
PËR PROJEKTET DHE BLERJET NË SHQIPËRI, NDËRMJET SHQIPËRISË  
DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit ekonomik, për projektet dhe blerjet në Shqipëri, ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI EKONOMIK**  
**PËR PROJEKTET DHE BLERJET NË SHQIPËRI NDËRMJET SHQIPËRISË DHE**  
**SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

Shqipëria, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Shtetet e Bashkuara) përfaqësuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së, në vijim bashkërisht të referuar si “Pjesëmarrës” dhe individualisht të referuar si “Pjesëmarrës”, “Shqipëria” ose “Shtetet e Bashkuara”:

*duke konfirmuar se* Pjesëmarrësit kanë marrëdhënie miqësore dhe produktive dhe kërkojnë përmirësimin e bashkëpunimit dypalësh në disa sektorë ekonomikë, në frymën e Deklaratës së Përbashkët të Partneritetit Strategjik;

*duke theksuar se* Pjesëmarrësit kërkojnë forcimin e mëtejshëm të lidhjeve ekzistuese ndërmjet dy vendeve të tyre dhe, në veçanti, kërkojnë nxitjen e pjesëmarrjes tregtare, eksportin e mallrave dhe shërbimeve dhe investimet nga sektori privat i Shteteve të Bashkuara në projekte dhe blerje të menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë;

*duke theksuar më tej se* Pjesëmarrësit synojnë që përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit Ekonomik (në vijim i referuar si “MBE”) të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik;

*duke pasur parasysh* Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit dhe Nismat e zbatueshme Rajonale Antikorrupsion;

*duke pasur, gjithashtu, parasysh se* reformat e orientuara drejt tregut dhe një kuadër i qëndrueshëm investimesh me stimuj të duhur taksash dhe mbrojtje të fuqishme të investitorëve janë të dobishëm për tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja;

*duke ritheksuar* qëllimin e tyre për të nxitur në Shqipëri një kuadër investimesh të hapur dhe jodiskriminues, paraqet kushte të barabarta, mbron investitorët dhe investimet, përfshin zgjidhjen e drejtë dhe të detyrueshme të mosmarrëveshjeve, ndjek rregullat e transparencës së qëndrueshme dhe pjesëmarrjes publike, promovon sjelljen e përgjegjshme të biznesit dhe bazon çdo rishikim të investimeve të huaja në rreziqe të mirëfillta të sigurisë kombëtare;

*duke konfirmuar* mbështetjen e tyre për tender dhe procese të prokurimit të hapura dhe të përgjegjshme;

*duke konfirmuar* hapjen e Shteteve të Bashkuara për ndarjen dhe qëllimin e Shqipërisë për të përfshirë praktikën më të mirë, në lidhje me prokurimin që integrojnë studimet e fizibilitetit të Pjesëmarrësve të tretë, përgatitjen e projektit që mund të përfshijë vendosjen e standardeve të

reja, ku nuk mund të zbatohen standarde të zbatueshme ndërkombëtare dhe vlerësimin e ofertave dhe procedurave të përzgjedhjes që përfshijnë analizën e kostos së ciklit jetësor për të përcaktuar vlerën më të mirë;

*duke ritheksuar* synimin e tyre se projektet dhe blerjet që do të kryhen në një mënyrë plotësisht, në përputhje me të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të synuara për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;

*duke ritheksuar, gjithashtu,* rëndësinë e ruajtjes së standardeve të larta të lidhura me shëndetin, sigurinë, mjedisin, punën, transparencën dhe qeverisjen e mirë për projektet dhe blerjet; dhe

*duke vepruar* në bazë të barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë,

kanë arritur mirëkuptimet e mëposhtme:

### **I. Bashkëpunimi ekonomik**

A. Pjesëmarrësit kanë interes të ndërsjellë në forcimin e lidhjeve tregtare dhe nxitjen e pjesëmarrjes tregtare nga shoqëritë amerikane në projektet dhe blerjet e menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë, me synim promovimin e prosperitetit, sigurisë dhe lidhjeve rajonale.

B. Pjesëmarrësit synojnë të inkurajojnë bizneset të kryejnë veprime në Shqipëri, në mënyrë të përgjegjshme dhe të harmonizojnë praktikën me udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe.

C. Në njohje të objektivave plotësues të Pjesëmarrësve, në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe blerjeve në Shqipëri, Shqipëria synon të ofrojë informacion (siç është një listë e projekteve qeveritare të prokurimit), që mund të ndahet gjerësisht nga Pjesëmarrësit me shoqëritë që mund të kenë interes për të marrë pjesë në këto projekte.

D. Sektorët e projekteve të synuara për bashkëpunim, në kuadër të MBE-së, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen tek:

1. Eksplorimi dhe zhvillimi i energjisë;

2. Infrastruktura (e përcaktuar nga Banka Botërore, si: projekte në sektorët e energjisë, transportit, ujit, teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe mbetjeve të ngurta bashkiake);

3. Turizmi;

4. Teknologjia;

5. Bujqësia.

E. Shqipëria synon të përfshijë praktikën më të mira të ndara nga Shtetet e Bashkuara për të siguruar që blerjet e menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë të jenë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare, duke përfshirë studimet e fizibilitetit të Pjesëmarrësve të tretë dhe procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ofertave që përfshijnë analizën e kostos së ciklit të jetës për të përcaktuar vlerën më të mirë.

F. Shtetet e Bashkuara synojnë të ndërmarrin hapat e duhur dhe të sigurojnë shoqëritë amerikane me informacion, në lidhje me financimin e mundshëm, duke përfshirë kreditë e eksportit, grantet dhe burimet e tjera qeveritare amerikane në dispozicion të aplikantëve të kualifikuar, siç është sigurimi i mbrojtjes tregtare, për të lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërive amerikane në projekte dhe blerje, duke përfshirë ato të financuara nga institucione financiare ndërkombëtare ose burime të sektorit privat.

G. Shtetet e Bashkuara konfirmojnë interesin e tyre për të promovuar pjesëmarrjen e shoqërive amerikane në projekte dhe blerje në Shqipëri dhe konfirmojnë qëllimin e tyre për t'u angazhuar përmes përdorimit të "ekipeve të marrëveshjes" të përbërë nga agjenci dhe programe amerikane, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek anëtarët e ekipit qendror të marrëveshjes DC: Departamentin e Shtetit të SHBA-së, Departamentin e Tregtisë të SHBA-së (i cili përfshin Shërbimin e Jashtëm Tregtar të Shteteve të Bashkuara), Departamentin e Mbrojtjes të SHBA-së, Departamentin e Energjisë të SHBA-së, Departamentin e Transportit të SHBA-së, Departamentin e Thesarit të SHBA-së, Agjencinë për Zhvillimin Ndërkombëtar të SHBA-së, Korporatën Financiare të Zhvillimit të SHBA-së, Agjencinë e Tregtisë dhe Zhvillimit të SHBA-së (USTDA), Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit dhe Bankën e Eksport-Importit të Shteteve të Bashkuara.

H. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara synojnë të promovojnë partneritete midis dhe në përfitimin reciprok të shoqërive amerikane dhe aktorëve lokalë të interesit në Shqipëri, duke përfshirë por pa u kufizuar të zhvillimi i fuqisë punëtore lokale, fuqizimi ekonomik i femrave dhe mundësitë për inovacion.

I. Shqipëria përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së synojnë të koordinohen me Ambasadën e Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara dhe Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri për promovimin e mundësive të biznesit përmes përdorimit të programit *webinar DirectLine*. *Webinar-ët DirectLine* mund të përdoren për të prodhuar lista të firmave amerikane që kanë interes në sektorët specifike ose në projekte ose blerje.

J. Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, synojnë të punojnë me agjencitë e tjera përkatëse të SHBA-së për të zhvilluar mundësi për ndihmë teknike në Shqipëri që përqendrohen në praktikat më të mira dhe standardet e njohura ndërkombëtare në menaxhimin e prokurimeve dhe të projekteve qeveritare.

K. Shqipëria përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së synojnë të koordinohen me Ambasadën e Shqipërisë në SHBA dhe Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri për përdorimin e burimeve të disponueshme të financimit, të tilla si: Fondi Nxitës i Lehtësimit të Biznesit të Departamentit të Shtetit ose Sigurimi i Mundësive për Fondin e Zhvillimit Ekonomik të Grave, për programet e promovimit tregtar dhe komercial në Shqipëri.

L. Pjesëmarrësit synojnë të shqyrtojnë bashkërisht përdorimin e mjeteve të tjera të qeverisë së SHBA-së, që mund të nxisin rritjen ekonomike në Shqipëri. Për shembull: Financimin e eksportit EXIM, financimin DFC, studimet e fizibilitetit USTDA dhe trajnime të tjera të përshtatshme të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, opsionet e financimit dhe asistencën teknike.

M. Pjesëmarrësit synojnë të lehtësojnë bashkëpunimin midis shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë përkatëse për të promovuar dhe zhvilluar aktivitete ekonomike të përbashkëta, si shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave, si dhe organizimin e forumeve të biznesit, panairëve të tregtisë, trajnimeve dhe konferencave.

## **II. Kushtet e përgjithshme**

A. Pjesëmarrësit synojnë të krijojnë një grup pune konsultimi dhe të identifikojnë pikat e kontaktit brenda një muaji nga nënshkrimi i kësaj MBE-je për t'u takuar në çdo moment që vendoset bashkërisht dhe paraprakisht nga Pjesëmarrësit për të diskutuar:

- i. mënyrën e zbatimit të kësaj MBE-je;
- ii. propozimet për rritjen e bashkëpunimit ekonomik;
- iii. pengesat që pengojnë bashkëpunimin ekonomik dypalësh dhe, sipas rastit, rekomandojnë zgjidhje;
- iv. çdo çështje tjetër që rrjedh nga kjo MBE.

B. Secili Pjesëmarrës mund të ndërpresë bashkëpunimin e tij, sipas kësaj MBE-je në çdo kohë. Një Pjesëmarrës, që dëshiron të ndërpresë bashkëpunimin e tij sipas kësaj MBE-je, duhet të bëjë përpjekje t'i japë Pjesëmarrësit tjetër një njoftim paraprak me shkrim të paktën gjashtë muaj përpara, mbi qëllimin e tij për këtë ndërprerje.

C. Kjo MBE nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve të treta ose të drejtat e Pjesëmarrësve për të lidhur marrëveshje, kontrata, protokolle ose angazhime të tjera në lidhje me çdo çështje të përshkruar në këtë MBE.

D. Pjesëmarrësit do të mbulojnë kostot dhe shpenzimet e tyre të cilat lindin gjatë zbatimit të kësaj MBE-je. Aktivitetet e zhvilluara nga Pjesëmarrësit, në lidhje me këtë MBE, varen nga disponueshmëria e fondeve dhe burimeve të tjera, dhe u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të vendeve të tyre përkatëse.

E. Kjo MBE nuk është ligjërishit e detyrueshme dhe nuk ka për qëllim të krijojë ndonjë të drejtë ose detyrim sipas ligjit të brendshëm ose ndërkombëtar.

F. Pjesëmarrësit synojnë të adresojnë çdo ndryshim mendimi që lind midis tyre, në lidhje me interpretimin e kësaj MBE-je, vetëm përmes konsultimeve miqësore.

G. Çdo rishikim i përmbajtjes së kësaj MBE-je do të bëhet me shkrim sikundërse përcaktohet nga Pjesëmarrësit.

Nënshkruar në \_\_\_\_\_, sot \_\_\_\_\_ 2020, në dy origjinale në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

**Për Shqipërinë**

Znj. Anila Denaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

**Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Z. Keith Krach

Zv. Sekretar i Shtetit për Rritjen Ekonomike, Energjinë dhe Mjedisin